

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm,** përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, në lëndën penale kundër të pandehurit Z. Z., me venbanim në fshatin M., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr. 109/2016, të datës 19.01.2016, të cilën e përfaqësonte Prokurorja Kujtesa Fazliu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 01.11.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë,

### A K T G J Y K I M

I pandehuri Z. Z., nga i ati A., e ëma H., e lindur M., i lindur më dt... në Gj., me vendbanim në fsh. ..., ka të kryer ..., punon në ..., i martuar-baba i ... fëmijëve, i gjendjes ekonomike e mesme, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

### Ë s h t ë f a j t o r

Sepse më dt....2016, rreth orës ... minuta, në fshatin M., në shtëpinë e tyre të përbashkët, i pandehuri, pas një mos-marveshje me të dëmtuarin-... M. Z., i cili është kthyer pas përfundimit të orarit të punës në gjendje të dehur në shtëpi nën ndikimin e alkoolit, ndaj të njëjtit përdorë forcën fizike, me ç' rast e godet me shuplaka dhe grusht në fytyrë.

me çka ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 50, 51, 73 dhe 75, të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarit i shqipton:

### DËNIM ME KUSHT

**I.** Të pandehurit Z. Z., i caktohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 100 (njëqindë) ditë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

**II.** Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

**III.** Obligohet i pandehuri të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbartimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Kundër të akuzuarit në fjalë është ngritur akti akuzues lëndor për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale lëndore të përshkruara më gjërë si në pikpamje faktike ashtu edhe juridike në vet aktin e tillë shkresorë.

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, të mbajtur më datën 01.11.2016, Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan Kujtesa Fazliu në fjalën përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

I pandehuri Z. Z. në fjalën përfundimtare deklaroi: e ndiej veten fajtor dhe jamë penduar shumë, jam pajtuar me ... të dëmtuarin M. dhe i kërkoj falje të dëmtuarit, kjo ka ndodhur rastësisht, më

parë nuk kam kryer veprën penale dhe i premtuj gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale dhe e lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim më të butë.

Në fillim të shqyrtimit fillestar pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit, i akuzuari Z. Z. ka deklaruar e pranojë fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila më vihet në barrë sipas kësaj aktakuze.

Gjykata, pas dëgjimit të Prokurorit, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, nga se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se i akuzuari Z. Z., ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-s, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për të njëjtën është përgjegjës penalisht.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata të pandehurin Z. Z., e shpalli fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale Sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-s, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale në fjalë dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73 të KP-s, si rrethana lehtësuese, e ka marrë për bazë sjelljen e mirë të akuzuarit gjatë mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, pranimin e fajësisë, i është përgjigjur ftesave të gjykatës, është penduar thellë dhe i ka kërkuar falje të dëmtuarit, më parë nuk ka kryer vepra penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, kurse si rrethanë rënduese, të merret shkalla e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmëria shoqërore.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me kusht, ndaj të akuzuarit Z. Z., është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KPRK-s.

Në kuptim të nenit 368 të KPP palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë, duke u paralajmëruar me rëndësinë e dënimit me kusht dhe kushtet të cilat duhet plotësuar që dënimi me kusht mos të revokohet duke u shendërruar në dënim efektiv.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 paragrafi 1-3 të KPP.

Nga të cekurat më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

**Departamenti i Përgjithshëm**

**P.nr. 150/2016, Më 01.11.2016**

**Sekretarja juridike,**

Igballe Azemi d.v

**Gj y q t a r i**

Behar Ymeri d.v

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të të njëjtit, përmes kësaj Gjykate.